



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2023:276659  
Datë: 21.06.2024  
Numri i dokumentit: 05847408

**PPP.nr.171/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit A.Z. nga fsh ..., Komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson av Afrim Tasholli nga Lipjani, kundër debitorit KEDS – Distrikti në Ferizaj, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 21.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit KEDS, me seli në Ferizaj, i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.691/24, të datës 07.11.2023, i lëshuar nga Përmbartuesi privat B.T. nga Ferizaj, dhe **MBETET NË FUQI** urdhri mbi lejimin e përmbartimit P.nr.691/24, i datës 07.11.2024.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin për përmbartim P.nr.691/24, të datës 07.11.2024, Përmbartuesi privat B.A., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit A.Z., kundër debitorit KEDS – Distrikti në Ferizaj, për përmbartimin e aktgjykimit C.nr.367/15, të datës 16.04.2019, për pagesën e kompensimit të dëmit në shumë prej 4,050 euro dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumë prej 25 euro, si dhe shpenzimet e përmbartimit, ose bllokimin e të gjitha llogarive bankare nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i lëshuar nga Përmbaruesi privat B.T., me numër P.nr.691/23, i datës 07.11.2023, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se propozimit për përmbarim si provë të emëruar në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm me qëllim të identifikimit të debitorit nuk përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 38, par 2, të LPP-së që është në shpërputhje me ligjin ashtu që siç përcakton ligji për procedurën përmbarimore, gjykata këtë pretendim e konsideron të pa bazuar sepse propozimi për përmbarim i kreditorit siç shihet i njëjti është përpiluar në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së për shkak se i njëjti siç konstatohet e përmban dokumentin përmbarimor siç është aktgjykimi C.nr.367/15, i dt.16.04.2019, në origjinal, kërkuar e përmbarimit apo kreditorin dhe debitorin, adresën e vendbanimit përkatësisht selisë së tyre, kredia që kërkohet të realizohet, objektin e përmbarimit si dhe të dhënat tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.

Po ashtu pretendimi i debitorit se urdhri për përmbarim është i përshtirë edhe me shkelje të tjera të procedurës përmbarimor nga se organi përmbarimor e ka lejuar përmbarimin me propozimin për përmbarim i cili nuk është i rregullt dhe nuk i plotëson kërkesat nga neni 38, par 1 dhe 2, të LPP-së, gjykata konsideron se edhe ky pretendim është i pa bazuar sepse siç është sqaruar edhe më lartë kreditori propozimin e tij për përmbarim e ka përpiluar në pajtim të plotë me kushtet ligjore që janë paraparë me nenin 38, par 1, të LPP-së dhe duke e marr parasysh këtë

fakt rrjedhë se urdhri për përmbarim i kundërshtuar me prapësim nga debitori nuk është i përshirë në shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbarimore.

Përveç tjerash, gjykata konsideron se aktgjykimi në bazë të cilit është nxjerr urdhri për përmbarim në këtë rast është në tërësi i përshtatshëm për përmbarim dhe në pajtim të plotë me kushtet ligjore të parapara me nenin 27, par 1, të LPP-së, sepse në aktgjykim është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e mbushjes së detyrimit siç është afati prej 7 ditësh, gjithashtu aktgjykimi në fjalë i përmbush edhe kushtet ligjore nga neni 36 par.1 i LPP-së, respektivisht i njëjti është dorëzuar nga kreditori së bashku me propozimin e tij për përmbarim në origjinal të tij me klauzolën e përmbarushmërisë për përmbarushmëri.

Si përfundim, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbarim P.nr.691/23, i datës 07.11.2023, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.691/23, më datë 21.06.2024**

**GJYQTARI**

**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.